

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Istogu – Raporti komunal

Tetor 2009

Istogu në shifra

Popullsia	Gjithsej	51,193
	Shqiptarë	90.9%
	Egjiptian	4.3%
	Boshnjak	3.2%
	Të tjerë	1.6%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	453.8
	Numri i fshatrave	50
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	18.34%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	35.99%
	E mesme	33.45%
	Shkollë e lartë	10.53%
	Universitet	1.70%
	Nr. i nxënësve	10423
	Nr. i mësimdhënësve	507
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	2
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	26
	Nr. i çerdheve	5
	Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		14
Nr. i mjekëve		26
Papunësia	Gjithsej	54.93%
	Meshkuj	52.72%
	Femra	61.06%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	31,228
	Të punësuar në sektorin publik komunal	924
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	5,038,352
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	578,500
	Të hyrat tjera (Euro)	4,459,852
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	4,117,059 (93%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	668,620 (88%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	3,448,439 (93%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	LDK	35.18%
	PDK	21.75%
	LDD	17.51%
	AAK	11.64%
	AKR	6.35%
	IRDK	1.89%
	SDA	1.70%
Tjera	3.98%	
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Sadri Ferati (LDK) 2002-2007: Sadri Ferati (LDK) 2007-2009: Sadri Ferati (LDK)	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Istogun

Istogu është njëra nga komunat përbërëse të regjionit të Pejës. Ka një sipërfaqe prej 453.8 km/2 dhe për nga madhësia territoriale kjo komunë radhitet e nënta në krahasim me komunat e tjera. Komuna e Istogut ka pak më shumë se 51,000 banorë. Si qytezë Istogu është shpallur më 1948, kurse territori i saj është përcaktuar më 1978. Qytetarët e viseve tjera të Kosovës e njohin Istogun ndër të tjera edhe për një fakt interesant: për kultivimin dhe përgatitjen e peshkut në ndërmarrjen “Trofta”.

Problemet aktuale

Problemet me të cilat përballen qytetarët e kësaj komune nuk dallojnë shumë nga pjesa tjetër e Kosovës. Brengë më e madhe e qytetarëve edhe më tutje mbetet papunësia, varfëria, energjia elektrike, etj. Rreth 54.93% e popullsisë në këtë komunë janë të papunë. Kjo shifër e radhit komunën e Istogut në vendin e tetë për nga shkalla e papunësisë. 782 familje me 3,522 anëtarë janë të varur nga ndihmat sociale që shpërndahen nga Qendra për Punë Sociale (MPMS). Sipas kësaj shifre 6.8% e popullsisë së kësaj komune jetojnë me ndihma sociale. Edhe pse një pjesë e madhe e popullsisë së kësaj komune janë të papunë, ata nuk regjistrohen në Qendrën Komunale të Punësimit si punëkërkues. Vetëm 6,045 të papunë apo 11.8% e popullsisë janë të regjistruar si punëkërkues. Natyrisht kjo shifër nuk shifër reale e papunësisë, pasi që qytetarët nuk i besojnë ndonjë përfitimi në rast se regjistrohen si punëkërkues. Problemet tjera me të cilat përballen kjo komunë janë:

- Mungesa e ujit të pijes;
- Ujërat e zaza/kanalizimi;
- Mbeturinat
- Prerja e pyjeve;
- Mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet;
- Mungesa e zyrave lokale për shërbim të qytetarëve.

Mungesa e Ujit të Pijes. Edhe pse Istogu konsiderohet se ka burime të mjaftueshme të ujit të pijes (madje edhe Klina është duke bërë përpjekje që të marr ujin nga kjo komunë), përsëri qytetarët përballen me problemet e ujit të pijes. Me mungesë të ujit të pijshëm, ballafaqohen rreth 7-8 fshatra të pjesës jugore të komunës. Megjithëse instalimi i sistemit të ujësjellësit ka përfunduar në këto fshatra, problemi qëndron në atë se ky sistem nuk është funksional, banorët kanë ende mungesë të ujit të pijshëm. Problemi është më i ndjeshëm në fshatrat Vrellë dhe Banjë. Në këto dy fshatra ka filluar projekti për rregullimin e ujësjellësit qysh para një viti mirëpo gypat e ujësjellësit janë shtruar vetëm në disa pjesë dhe projekti ka ngecur në atë fazë. Ndërkaq, pas ankesave të shumta të banorëve, komuna është deklaruar se ky projekt do të zhvillohet në disa faza dhe do të zgjasë së paku edhe dy vite. Po ashtu, pjesa lindore e qytetit ka probleme me furnizim me ujë të pijes, mirëpo në këtë pjesë gjendja është pak më ndryshe pasi që banorët në fakt furnizohen me ujë përmes pompave. Por këto pompa varen nga energjia elektrike dhe në mungesë të kësaj të fundit ndalet edhe uji.

Ujërat e Zeza/Kanalizimi. Problemi i ujërave të zeza është problem serioz për disa fshatra të Komunës së Istogut siç janë: Surigana, Cerkuzezi, Uça dhe Rakoshi. Nga këto fshatra, vetëm Rakoshi posedon sistemin e kanalizimit ndërsa 3 fshatrat e tjera nuk kanë fare. Mirëpo, edhe në Rakosh banorët ballafaqohen me probleme të mëdha

rreth ujërave të zeza pasi që rrjeti është i vjetruar dhe në disa pjesë shpesh ndodh që të mbyllet rrjedha e kanalizimit. Shqetësim tjetër për banorët është edhe kundërmimi që vjen si pasojë e këtyre ujërave.

Mbeturinat. Problem tjetër serioz për komunën e Istogut është dhe problemi me deponinë e mbeturinave të qytetit e cila ndodhet në Dubravë. Deponia gjendet në vend të papërshtatshëm, është e stërmbrushur, mbeturinat kundërmojnë në të gjithë vendin dhe në raste të fryrjes së erës mbeturinat shpërndahen gjithandej dhe futen në oborret e shtëpive. Organet komunale kanë ndërmarrë masa në zgjidhjen e këtij problemi duke ndarë një truall në fshatin Tyçep në të cilin është planifikuar që kjo deponi të zhvendoset. Mirëpo komuna nuk i ka ndarë mjetet e nevojshme për futjen në funksion të kësaj deponie.

Prerja ilegale e pyjeve në Bjeshkët e Istogut. Një problem tjetër shumë shqetësues për banorët e komunës së Istogut është dhe fenomeni i prerjes së pyjeve në bjeshkët e Istogut. Pasuritë natyrore të Istogut po dëmtohen çdo ditë përderisa askush nuk ndërmerr asgjë në këtë drejtim. Këto pyje përveç që prehen, vidhen dhe shkatërrohen nga banorët e fshatrave afër bjeshkëve, ato po prehen edhe nga banorët serb të fshatrave që gjenden matan kufirit. Deri më tani pyjet janë menaxhuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës dhe autoritetet komunale nuk janë ndjerë përgjegjës para këtij fenomeni negativ. Me Ligjin e ri për pyjet, i cili pritet të miratohet së shpejti nga Kuvendi i Kosovës, menaxhimi i pyjeve i lihet në përgjegjësi autoriteteve lokale. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës për vitin 2008, nga 795 rastet e regjistruara për prerjen e pyjeve në tërë Kosovën, 244 prej tyre apo 30.6% të rasteve janë regjistruar në Komunën e Istogut.

Mungesa e Hapësirave të Gjelbëruara në qytet. - Qytetarët e Istogut ankohen se në këtë qytet nuk ka pothuajse fare hapësira të gjelbëruara, përveç një parku të vogël i cili është i shkatërruar, jo-funksional dhe nuk mirëmbahet. Ndërtimet e shumta, veturat dhe parkingjet e kanë ngulfatur qytetin dhe banorët nuk kanë asnjë park të vetëm që do të mund ta shfrytëzonin për rekreacion dhe shëtitje.

Mungesa e Zyreve Lokale të Shërbimeve për Qytetarë. Një problem tjetër karakteristik për fshatrat e komunës së Istogut është edhe largimi apo tërheqja e të gjitha zyrave lokale të shërbimeve për qytetarët nga fshatrat. Sipas banorëve, më herët këto zyre kanë ekzistuar edhe nëpër fshatra mirëpo para një viti Komuna i ka mbyllur ato dhe tani zyrat e vetme gjendet në Istog. Banorët e fshatrave ankohen se për çdo shërbim ata duhet të udhëtojnë për në qytetin e Istogut pasi që nuk mund të kryejnë asnjë shërbim në vendbanimet e tyre. Vrella, Dobrusha, Banja, Rakoshi dhe Uça janë vetëm disa nga fshatrat e Komunës së Istogut në të cilat nuk ka zyre lokale të shërbimeve për qytetarë. Komuna arsyetohet se tërheqja e stafit nga zyret lokale dhe mbyllja e këtyre zyreve është bërë për shkak se komuna ka qenë e detyruar që të zvogëloj numrin e stafit administrativ. Dhe zvogëlimi i stafit është bërë duke u nisur nga zyret lokale dhe jo në administratën në qytet.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Istogu është e vetmja komunë në Kosovë e cila për tri mandate është udhëhequr nga i njëjti person. Fadil Ferati nga LDK ka rritë që nga viti 2000 të mbaj postin e kryetarit të komunës. Përderisa në dy mandatet e para Fadil Ferati ishte zgjedhur kryetar

komune përmes votimit në Kuvendit Komunal, pasi që ishte udhëheqës i partisë e cila ka fituar numrin më të madh të ulëseve, në zgjedhjet e treta lokale Fadil Ferati duhej të konkurronte në zgjedhjet e drejtpërdrejta për kryetar komune, në bazë të ndryshimeve që u bënë në Rregulloren e UNMIK-ut për vetëqeverisje lokale. Edhe në zgjedhjet e drejtpërdrejta Fadil Ferati arriti të fitoi vota të cilat i dhanë të drejtën që të qeverisë edhe një mandat me këtë komunë. Në raundin e parë të zgjedhjeve lokale të vitit 2007, Fadil Ferati arriti të fitonte 6.650 vota apo 42.61%, kurse në raundin e dytë fitoi 8.664 vota apo 63.4%.

Premtimet të cilat u dhanë nga kryetari aktual i komunës në fushatën elektorale 2007 kishin të bënin me furnizim me ujë të pijes, asfaltim të rrugëve, investime në sport dhe pyllëzim. Gjatë 2008 ka pasur investime në rrjetin e ujësjellësit si dhe janë ndarë mjete për hartim të projekteve për ujësjellës. Me 6,000 € të ndara është bërë hartimi i projekteve të ujësjellësit për fshatrat Dobrushë, Staradran dhe Trubuhoc; kurse me 10,000 € komuna ka participuar në projekte të ujësjellësit me komunitetin. Mirëpo, problemi me ujë nuk është zgjidhur në tërësi. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit nuk ka pruar ujë të mjaftueshëm në shtëpitë e qytetarëve të kësaj ane. Edhe më tutje furnizimi me ujë është një nga problemet më të mëdha që hasin qytetarët.

Premtimi i cili nuk është përmbushur është ai për pyllëzimin e pyjeve. Prerja e pyjeve në Komunën e Istogut është një nga problemet më të mëdha të kësaj komune. Tabela më poshtë pasqyron premtimet e dhëna nga kryetari i komunës në debatet zgjedhore 2007 në “Jeta në Kosovë” dhe realizueshmëria e tyre.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Ndërtimi i ujësjellësit në pjesën jugore të komunës së Istogut, në fshatrat Zabllaq, Trubovc, e tutje.	Është shtrirë rrjeti i ujësjellësit, mirëpo këto lokalitete kanë problem me furnizim me ujë.
Asfaltimi i rrugës Rakosh-Uçë-Rakovë-Dubravë	Projekti është realizuar.
Ndërtimi i palestrës e sporteve në vitin 2008, ku për fazën e parë Ministria e Kulturës ka ndarë 330.000 euro.	Gjatë vitit 2008, me 19,000 euro të komunës është hartuar projekti i palestrës së sporteve. Në 2009. Për fazën e parë Ministria e Kulturës ka ndarë 330,000 euro; kurse për fazën e dytë MAPL ka kontribuar me 100,000. Objekti është në ndërtim e sipër dhe nuk dihet kur do të përfundohet.
Pyllëzimi i pyjeve rrëzë bjeshkëve të Vrellës	Projekt i pa realizuar.

Zgjedhjet lokale në Istog

Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme lokale, në Kuvendin Komunal 31 anëtarësh ka mbizotëruar LDK. Në zgjedhjet e para lokale të 2000, LDK mori 12,721 vota që përkthyer në ulëse ky subjekt fitoi 22 ulëse në KK, duke lënë mbrapa PDK-në me 5 ulëse dhe AAK-në me 3. Edhe në zgjedhjet e dyta lokale dy vite më vonë LDK fitoi shumicën e ulëseve, por kësaj here me një rënie prej afro 2,000 votave. PDK arriti të fitoj disa vota më shumë dhe një vend më shumë në KK, kurse AAK mbajti numrin e njëjtë të ulëseve përkundër një rritjeje të lehtë në vota. Rënia e LDK në vota vazhdoi edhe në 2007, pasi që votat ju përgjysmuan dhe fitoi vetëm 11 ulëse, nga 18 sa kishte

në mandatin e dytë dhe 22 në mandatin e parë. PDK dhe AAK fituan nga një ulëse më shumë. Përkundër përgjysmimit të votave, sërish LDK arrit të mbaj shumicën në KK, kësaj radhe duke hyrë në koalicion me AAK-IRDK-SDA, që së bashku përbëjnë shumicën prej 17 deputetësh. Në këto tri mandate, siç mund të shihet më qartë nga tabela 2, vetëm tri parti kanë qenë të përfaqësuara vazhdimisht në KK. Prej mandatit të ardhshëm Kuvendi Komunal i Istogut do të ketë katër ulëse më pak.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Istogut.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	2931	5	3289	6	3257	7
LDK	12721	22	10755	18	5268	11
AAK	1630	3	1740	3	1743	4
LDD	-	-	-	-	2622	5
AKR	-	-	-	-	951	2
IRDK	-	-	-	-	283	1
SDA	453	1	-	-	254	1
PSHDK	-	-	318	1	-	-
IRDK	-	-	398	1	-	-
“Povratak”	-	-	557	1	-	-
VATAN	-	-	358	1	-	-

Në anën tjetër, numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte 80.9%, dy vite më vonë pjesëmarrja në votime ra në 52%. Edhe në zgjedhjet e treta lokale dalja në votime shkoi duke rënë dhe kësaj radhe ishte 47.3%. Në zgjedhjet e balotazhit për kryetar komune tri javë më vonë, pjesëmarrja ishte edhe më e vogël se në zgjedhjet e 17 nëntorit, pasi që pjesëmarrja ra në 43%. Në zgjedhjet e ardhshme lokale të 15 nëntorit 2009 të drejtë vote në këtë komunë kanë 42,877 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Istog në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
Votues me të drejtë vote	22899	35247	31657
Pjesëmarrja në votime	18525	18341	14974
Përqindja e daljes në votime	80.9%	52%	47.3%

Buxheti i Komunës

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Istogut për vitin 2009 ka arritur shumën 5,038,352 €. Kjo shifër është më e larta ndonjëherë në këtë komunë. Buxheti i përgjithshëm i komunës ka shënuar rritje të vazhdueshme nga viti në vit, përveç në vitin 2007 ku planifikimet buxhetore kanë qenë më të vogla se sa një vit më parë. Por kategoria e cila ka shënuar rritje të vazhdueshme për çdo vit ka qenë ajo e “rrogave dhe mëditjeve”. Rritja më e madhe e mjeteve për rroga dhe mëditje është bërë në 2009. Rritja e shpenzimeve për paga dhe mëditje është bërë në mënyrë të

vazhdueshme edhe pse numri i punonjësve në nivel komunal (arsim, shëndetësi dhe administratë) ka shënuar rënie nga viti në vit.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	€2,863,962	€528,483	€120,991	€87,200	€1,437,716	-	€5,038,352
2008	€2,409,279	€555,443	€121,000	€87,200	€660,036	-	€3,832,958
2007	€2,321,253	€533,133	€123,838	€63,000	€471,124	-	€3,512,348
2006	€2,318,761	€479,424	€109,500	€70,000	€1,181,779	-	€4,159,464
2005	€2,254,374	€507,892	€129,660	€135,358	€659,499	-	€3,686,783
2004	€2,237,771	€869,240	-	-	€365,064	€95,000	€3,567,075
2003	€1,795,542	€1,095,351	-	-	€236,036	€95,113	€3,222,042

Nga buxheti i përgjithshëm i komunës prej 5.03 milion €, të hyrat vetanake përbëjnë 11.4% të këtyre mjeteve. Pjesa tjetër sigurohet përmes grantit qeveritar. Buxheti i vitit 2008 ka arritur që të shpenzohet në masën 93%. Inkasimi i të hyrave vetanake të komunës ka tejkaluar parashikimet. Gjatë 2008 të hyrat vetanake kanë qenë 475,000 €, që do të thotë realizimi i të hyrave është arrit në masën 103.8%.

Investimet kapitale

Buxheti i komunës i destinuar për investime kapitale për dy vitet e fundit ('08-'09) kap shifrën prej 2,097,752 euro, apo 23.6% e buxhetit të përgjithshëm. Edhe niveli qendror ka investuar në projekte të ndryshme kapitale gjatë këtyre dy viteve, si në rrjet të ujësjellësit, terrene sportive, asfaltim të rrugëve, etj. Tabela më poshtë pasqyron disa nga projektet kapitale të cilat janë kryer me buxhet të komunës në dy vitet e fundit.

Tab.5.: Investimet kapitale në Istog gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Plani zhvillimor i komunës së Istogut	€ 39,944
2008	Hartimi i projektit të shkollës fillore "Ismajl Qemali" - Staradran	€ 24,689
2008	Pajisja e shtëpisë së kulturës me inventar dhe zërim	€ 7,000
2008	Rregullimi i stadiumit të futbollit në Istog	20,000
2009	Ndërtimi i urës në fshatin Shushicë e poshtme	€7,000
2009	Ndërtimi i trafos në fshatin Cërcë	€20,000

Kuvendi Komunal i Istogut ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Istogut do të ketë në dispozicion 6,482,021 € për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Istogut 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	5,825,462	5,964,652	6,174,767
Të hyrat vetanake në €	740,670	764,183	786,227
Investimet kapitale në €	2,036,328	2,165,552	2,280,141

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Istogut për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se 8.7 milion € për investime kapitale.

Administrata komunale

Në sektorin publik në nivel komunal (arsim, shëndetësi dhe administratë) në Istog në këtë vit janë të punësuar 924 veta. Ky numër nuk ka ndryshuar nga viti i kaluar, kurse nga viti 2007 janë të punësuar dy punonjës më pak. Nga ky numër, në administratën komunale të Istogut janë të punësuar 140 veta, prej tyre 33 femra apo 23%, kurse 39.7% e punonjësve të administratës janë me shkollim superior. Sipas një vendimi të Qeverisë së Kosovës (vendimi 10/46 i 3 dhjetorit 2008), komunat me më pak se 100,000 banorë duhet të kenë të punësuar një shërbyes civil për 620 banorë. Sipas kësaj formule del se Komuna e Istogut nuk duhet të ketë më shumë se 126 shërbyes civil.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Istogut sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	924 ■
2008	924
2007	926
2006	948 ▲
2005	944
2004	964 ▲
2003	918 ■

Shërbimet administrative komunale nuk janë në nivel të duhur. Krijohen radhë të gjata për marjen e dokumenteve dhe për kryerjen e obligimeve ndaj komunës. Nuk ka asnjë ndryshim në dinamikën e punës së administratës pas zgjedhjeve të reja. Sipas bashkëbiseduesve, nuk ka disiplinë në punë. Në të shumtën e kohës zyrtarët nuk mund të gjenden në zyret e tyre të punës. Administrata komunale është centralizuar shumë. Komuna ka mbyllur zyret e vendit në Vrellë, Banjë dhe Rakosh. Tani të gjithë qytetarët e komunës vërshojnë objektin kryesor të komunës për të marrë dokumentet e tyre.

Komuna e Istogut dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Kuvendi Komunal i Istogut në masë të madhe ka funksionuar konform Ligjit për vetëqeverisje lokale. Gjatë vitit 2008, KK i Istogut ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta, aq sa kërkohen edhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Gjatë pjesës së parë të 2009 KK i Istogut ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar katër rregullore. 10 mbledhje gjatë 2008 ka mbajtur edhe komiteti për i rëndësishëm komunal – Komiteti për Politikë dhe

Financa (KPF). Gjatë periudhës janar-qershor 2009 KPF ka mbajtur pesë mbledhje. Gjatë vitit 2008 Kryetari i kësaj komuna ka mbajtur dy tubime me qytetarë, aq sa kërkohen minimum me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Komuna e Istogut është një ndër komuna që më së paku ka mbajtur tubime publike me qytetarë gjatë 2008. Gjatë pjesës së parë të 2008 Kryetari i Komunës nuk ka mbajtur asnjë tubim publik me qytetarë, kurse me Ligj kërkohet që njëri nga dy tubimet publike të mbahen në pjesën e parë të vitit. Mos mbajtja e dëgjimeve publike këtë vit është arsyetuar me atë e kryetari është duke kaluar nëpër një periudhë të vështirë shëndetësore. Gjatë 2008 dhe deri më tani nuk ka pasur asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare dhe asnjë petition të dorëzuar në komunë.

Faqja zyrtare e internetit është funksionale, mirëpo në këtë faqe nuk mund të gjendet asnjë informatë rreth asaj se si funksionon komuna, cilat janë vendimet e saj, si kanë shkuar debatet në Kuvendin Komunal, etj. Nëse klikoni në kategoritë që gjenden në këtë faqe, të gjitha janë të zbrazëta; për shembull buxheti i komunës nuk është ri freskuar që nga viti 2006.

Tab.6. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Istogut (<http://www.komuna-istog.org/>)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	3
Organizimi komunal	2.67
Shërbimet komunale	1
Info rreth qytetit	1.75
Projektet komunale	1.25
Lajme& lajmërimë	2
Harta e faqes	1
Kontakt	1
Gjuhët	2
Fusha për kërkim	1
Tjera informacione shtesë	1
Baza Ligjore	2
Mesatarja totale	1.64
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	27

Gjendja në arsim

Sistemi edukativo-arsimor në komunën e Istogut është i organizuar në tri nivele: arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm. Istogu ka 5 çerdhe për fëmijë dhe pas Prishtinës dhe Gjakovës radhitet e treta për numrin e çerdheve. Në komunën e Istogut janë gjithsej 26 shkolla fillore (2 prej tyre në gjuhën serbe), 2 shkolla të mesme (Gjimnazi "Haxhi Zeka" në Istog dhe Shkolla e Mesme Teknike Profesionale "Mit'hat Frashëri" Gurakoc).

² (rradhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Në mjetet vetanake të komunës është riparuar kulmi i shkollës fillore në Banjë, është hartuar projekti i shkollës fillore në Saradran dhe hartimi i projektit për ndërtimin e shkollës fillore "Bajram Curri" në Istog. Kanë përfunduar punimet në shkollën fillore në Gurrakoc dhe në atë të Kalishanit. Objekti i shkollës fillore në Gurrakoc ka filluar që dy vite dhe janë zvarritur punimet. Në shkollën e Kalishanit ende pa u kryer mirë punimet ka filluar që të pikoje kulmi, si rezultat i punimeve të dobëta që janë kryer. Në vitin 2009 parashihet renovimi i dy objekteve shkollore, blerja e kabinetit të fizikës në një shkollë, dhe rregullimi i nyjeve sanitare. Përveç objektit të gjimnazit të qytetit i cili është në gjendje jo të mirë dhe ai i shkollës fillore në Bajë, shkollat tjera janë në gjendje të mirë dhe se infrastruktura shkollore është e kompletuar.

Në arsimin fillor dhe të mesëm edhe më tutje mbetet problem angazhimi i mësimitdhënësve të kualifikuar për lëndët e anglishtës, matematikës, fizikës, kimisë, artit. Në total, vetëm 22,3% e mësimitdhënësve janë me shkollim superior. Problem tjetër me të cilin përballen shkollat është dhe mungesa e bibliotekave.

Gjendja në shëndetësi

Në komunën e Istogut, ekziston Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, katër Qendra të Mjekësisë Familjare në lokalitetet: Vrellë, Banjë, Gurrakoc, dhe Rakosh. Gjithashtu ekzistojnë edhe 10 Ambulanca në tërë territorin e komunës. Përveç enteve publike shëndetësore, në Komunën e Istogut, aktivitetin tyre e ushtrojnë edhe një numër i konsiderueshëm i ordinancave private që janë gjithsej 16.

Në vitin 2008 komuna ka rinovuar ambulancën në Veriq dhe përveç këtij investimi nuk ka pasur investime tjera. Në listën e investimeve kapitale për 2009, parashihen 140,000 euro investime kapitale në shëndetësi, si: laborator në QMF-të e Banjës dhe Vrellës, instalimi i ngrohtores në QMF Vrellë, blerja e automjetit për dializë, rinovimi i QMF Gurakoc, rëntgen aparat për dhëmbë, rëntgen aparat në QKMF, etj. Objekti i shtëpisë së shëndetit është shumë i vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për punë. Komuna në konferencën e donatorëve ka paraqitur një projekt prej 1 milion e 400 mijë euro për ndërtimin e një objekti të ri shëndetësor. Momentalisht QKMF nuk ka drejtor dhe udhëhiqet nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Istogut.

Shoqëria civile

Në komunën e Istogut shoqëria civile nuk është mjaft aktive. Edhe pse një numër i madh i organizatave joqeveritare janë të regjistruara, shumica prej tyre kanë shuar aktivitetet ose aktivizohen herë pas here. Shoqëria civile nuk ka treguar ndonjë interesim në monitorimin e punës së pushtetit komunal, apo organizimin e shoqërisë për të formuluar kërkesat e tyre në drejtim të komunës. Organizatat të cilat janë aktive zakonisht merren me çështje rinore dhe me avancim të pozitës së gruas në jetën publike komunale.

Mediat lokale

Në komunën e Istogut funksionin një radio lokale, Radio "Fontana". Ky medium transmeton program të rregullt argëtues dhe informativ. Në bazë të një kontrate me komunën që nga viti i kaluar Radio "Fontana" bën transmetimin e mbledhjeve të Kuvendit Komunal. Me ndryshimet që i janë bërë Ligjit për vetëqeverisje lokale, pushteti ka kaluar nga Kuvendi në bordin e drejtorëve. Mediat edhe më tutje vazhdojnë ti kushtojnë më shumë rëndësi legjislativit komunal, se sa ekzekutivit. Përveç radios, edhe mediat e shkruara kanë gazetarët e tyre të përhershëm në këtë komunë. Për aktivitetet komunale në Istog, shpesh mund të lexojmë edhe në kronikat lokale që përmbajnë gazetatat si "Koha Ditore" dhe "Zëri", gazetarët e të cilave janë më aktiv dhe më objektiv në raportimet e tyre.

Rendi dhe ligji në Komunën e Istogut

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Istogut kanë ndodhur 1518 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 55 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Istogut (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	161
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	88
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	14
Vjedhje e pyjeve	244
Incidente lidhur me pronën	65
Vjedhje	199
Abuzime seksuale	7
Shkaktim të dëmtimeve trupore	48
Kërcënime	48
Mashtrime	6
Vrasje	3
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	-

Nga numri i rasteve të shënuara gjatë vitit 2008, shihet se Istogu është një komunë relativisht e qetë dhe në krahasim me komunat e tjera radhitet në vendin e 11. Por sa i përket vjedhjes së pyjeve, kjo komunë radhitet në vendin e parë. Prerja e pyjeve është një nga shqetësimet më të mëdha të qytetarëve. Numri prej 244 rasteve të vjedhjes së pyjeve që janë regjistruar nga policia e Kosovës, është i vogël në krahasim me rastet që ndodhin dhe nuk vërehen nga policia, apo autoritetet e Agjencionit Pyjor të Kosovës.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifatat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Istogut

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.15%	0.15%	0.20%	0.20%	0.10%
I	300	250	600 €	450 €	100
II	250	200	500 €	400 €	80
III	180	180	400 €	350 €	60
IV	150	150	300 €	300 €	40

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë janë të regjistruara rreth 1,100 biznese të cilat operojnë në komunën e Istogut, prej tyre mendohet se 478 janë aktive. Veprimtaria e tyre mund të përmbledhet dhe të ndahet në këta sektorë: 43% tregtare; 10% hoteliere; 13% transportuese, 34% tjera. Të gjitha këto biznese përveç regjistrimit në MTI, duhet të marrin lejen e punës e cila lëshohet në nivel komunal. Duke u bazuar në Rregulloren komunale për taksat, ngarkesat dhe gjobat, e miratuar nga Kuvendi Komunal i Istogut më 12 mars 2009, kemi nxjerr disa nga bizneset dhe shuma që ato duhet të paguajnë për leje vjetore të punës:

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	400 €
Kompanitë e sigurimit	224 €
KEK	400 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	400 €
Bastoret sportive	160 €
Agjensionet turistike	-
Hotelet	280 €
Motelet	184 €
Supermarketet-Hipermarketet	240 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	120 €
Kafeteritë	56 €
Restorant	104 €
Telekomunikimit	64 €
Barnatoret	120 €
Autoshkollat	80 €
Punëtoritë (argjendaritë,	40 – 80 €

zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	
Ngarkesa vjetore për menaxhimin e mbeturinave,ujit dhe kanalizimit	140 €
Pompat e benzinës	224 €
Ndërmarrjet ndërtimore	144 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	64 - 104 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 - raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 "Jeta në Kosovë", www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report - Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika ne lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.